




|                                                                                     |                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO                             |                                     |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                     |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.                                                                | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. |
| 2-0/OPK                                                                             | 01-1446/15                          |
| Nr. titull<br>Bro. shënime                                                          | Data<br>Datum                       |
|                                                                                     | 28-05-2015                          |
| PRISTINE                                                                            |                                     |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.05.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-816-15 për znj. *Sebiha Shala* – Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit “Haxhi Zeka” dhe e angazhuar përkohësisht për mësimdhënëse në Fakultetin Juridik të këtij Universiteti, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë situatën si kufizim apo ndelesë, duke e cilësuar si konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-816-15, për Zyrtaren e lartë, znj. *Sebiha Shala* – Anëtare e Këshillit Drejtues në Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë, dhe njëkohësisht e angazhuar përkohësisht si ligjëruese për semestrin dimëror 2014/2015, në po të njëjtin Universitet, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtarja e lartë, znj. *Shala* fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast, është njoftuar me pretendimet nga një palë e tretë për situatë të dyshuar për konfliktit interesit duke qenë se znj. *Shala* ushtron funksionin e Anëtarit të Këshillit Drejtues të Universitetit “Haxhi Zeka”, dhe njëkohësisht edhe është e angazhuar përkohësisht si ligjëruese në po të njëjtin Universitet.

Nga takimin me zyrtaren e lartë znj. *Shala*, jemi njoftuar se për angazhimin e saj si ligjëruese e përkohshme ajo ka hequr dorë nga pagesa që i takon.

Po ashtu, znj. *Shala* ka njoftuar se ka bërë një Kërkesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ne lidhje me ligjshmërinë e angazhimit të saj në mësimdhënie, përderisa

njëkohësisht është edhe Anëtare e Këshillit Drejtues. MASHT deri më tani nuk i ka dërguar asnjë njoftim lidhur me këtë çështje.

Një sqarim nga Zyra ligjore në MASHT, në lidhje me këtë çështje ka kërkuar edhe Agjencia kundër Korrupsion, (ZD-01-1308/15), por në përgjigjen që kemi marr (Dpki-03-02-1421/15) Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në MASHT-it ka përshkruar vetëm nenin 18 paragrafi 2 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, që faktikisht nuk ishte përgjigje konkrete e pyetjes sonë.

Te njëjtën Kërkesë zonja Shala e ka bërë edhe në Universitetin “Haxhi Zeka” duke deklaruar se që në momentin e caktimit të një zyrtari përgjegjës për interpretimin e Statutit të Universitetit të kërkohej nga i njëjti interpretim për çështjen në fjalë.

Ndërkohë në takime të veçanta me znj.Shala, dhe me palën denoncuese, kemi sqaruar pikërisht Nenin 18 paragrafi 2 në të cilin thirret pala denoncuese se pikërisht kjo pikë sipas tyre ja ndalon ushtrimin e detyrës së mësimdhënëses gjatë kohës së të qenurit Anëtare e Këshillit Drejtues.

Neni 18 paragrafi 2 i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” shprehimisht thotë:

***”Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë emëron tre (3) anëtar me të drejtë vote dhe ata emërohen sipas dispozitave të Ligjit mbi Arsimin e Lartë. Ata duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste si dhe me aftësi të tjera praktike. Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet”.***

Pikërisht fjalia e fundit e këtij paragrafi ka qenë “bazë” për pretenduesit që thotë: ***“...Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet”.***

Por, gjatë interpretimit logjik, del se në të po thuhet; ***“...lidhje të drejtpërdrejta aktuale...”*** që faktikisht rezulton se në momentin e emërimit nuk ka pas lidhje të drejtpërdrejta.

D.m.th. fjala “aktuale” nënkupton lidhjet në momentin e emërimit për Anëtar të Këshillit Drejtues.

Ndërsa, për të forcuar qëndrimin se në këtë situatë nuk ka konflikt interesi, pastaj duhet të bazohemi në nenin 10 paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik i cili shprehimisht thotë:

***“Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtroj punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”.***

Ndërsa, po ashtu nuk qëndron as pretendimi tjetër për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik se znj.Shala ka konkurruar në Konkursin e shpallur nga Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë për mësimdhënëse në Fakultetin Juridik.

Çështja e hapjes së Konkurseve nuk është në kompetencën e Këshillit Drejtues, por vjen pas kërkesës së Njesisë akademike (Neni 66 paragrafi 1.7) dhe me aprovimin nga Senati (Neni 47 paragrafi 1.3).

***“I gjithë personeli akademik emërohet nga Rektori sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njesisë akademike”***, (Neni 169 , paragrafi 1 i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” Pejë).

Ndërsa, nëse, eventualisht, znj.Shala zgjidhet për mësimdhënëse e rregullt, sipas kriterëve të konkursit të Universitetit “Haxhi Zeka”, për të ruajtur rregullin e zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Drejtues (4+3), ajo do të duhej të jap dorëheqje nga të qenurit Anëtare e Këshillit Drejtues sepse atje, bashkë me dy anëtar tjerë, është në cilësinë e të emëruarës nga Ministri i

Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (Neni 18 paragrafi 2 i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” Pejë).

Kurse, “Senati zgjedhë katër (4) anëtarë të Këshillit drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i Universitetit”, (Neni 18 paragrafi 3 i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” Pejë).

Po ashtu meqenëse aktualisht znj. Shala është zëvendës kryesuese e Këshillit Drejtues të “UHZ”, dorëheqja e saj nga kjo pozitë në rastin e zgjedhjes së saj për mësimdhënëse në Fakultetin Juridik bazohet edhe në nenin 19 paragrafi 1 i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” i cili shprehimisht thotë:

***“Këshilli Drejtues çdo vit zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin prej anëtarëve të vet, të cilët nuk janë punonjës të institucionit”.***

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

